



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 maj 2016
Nr. ref.: RK933/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI95/15

Parashtrues

Xhevat Berbati

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 4312/2014, të 27 shkurtit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare, dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Xhevat Berbati, me vendbanim në Nabërgjan, komuna e Pejës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin (Ac. nr. 4312/2014, e 27 shkurtit 2015) e Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit), të cilin parashtruesi pretendon që e ka pranuar më 1 prill 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili ka refuzuar prapësimin e parashtruesit kundër Vendimit (E. nr. 1023/2013, të 23 dhjetorit 2013) të Gjykatës Themelore në Pejë në lidhje me lejimin e inicimit të procedurës së përmbarimit kundër parashtruesit dhe garantuesve të tij.
4. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) konkretisht “*neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] paragrafi 1; neni 32 [E drejta për Mjete Juridike] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]*”.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 10 korrik 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 19 gusht 2015, Kryetarja, me Vendimin GJR. KI95/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin, KSH. KI95/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 18 janar 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
9. Më 16 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 27 shkurt 2012, parashtruesi nënshkroi një marrëveshje kredie, si autorizim për mbitërheqje, me Bankën Ekonomike SH. A. (në tekstin e

mëtejme: Banka Ekonomike). Të njëjtën ditë, parashtruesi, garantuesit e tij dhe Banka nënshkruan një marrëveshje për hipotekë si mjet për sigurimin e pagesës së kredisë.

11. Kredia iu lëshua parashtruesit të kërkesës. I njëjti i kishte paguar këstet, siç ishte dakorduar me Bankën, deri në një datë të caktuar. Pas disa vështirësive financiare, parashtruesi i kërkesës filloi të vonojë pagesat e planifikuara dhe në një kohë të caktuar e ndërpreu pagesën e kësteve të dakorduara.
12. Pas këtyre ngjarjeve dhe pasi që riprogramimi i kredisë dështoi të japë rezultate, Banka, në cilësinë e kreditorit, paraqiti propozim për përmbarim ndaj parashtruesit dhe garantuesve të tij, në cilësinë e debitorëve, në Gjykatën Themelore në Pejë. Banka kërkoi nga Gjykata Themelore në Pejë të detyrojë parashtruesin dhe garantuesit e tij që të paguajnë shumën e borxhit të mbetur apo si alternativë të autorizojë shitjen e hipotekës së lënë nga garantuesit, si mjet për të paguar borxhin e mbetur.
13. Më 23 dhjetor 2013, Gjykata Themelore në Pejë (Vendimi E. nr. 1023/203) miratoi propozimin për përmbarim në bazë të kontratës së kredisë të nënshkruar nga parashtruesi dhe Banka, dhe në bazë të kontratës së hipotekës të nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës, garantuesit e tij dhe nga Banka.
14. Kundër vendimit të lartpërmendur, parashtruesi dhe garantuesit e tij kanë paraqitur prapësim në Gjykatën e Apelit, duke kërkuar nga e njëjta të anulojë Vendimin e Gjykatës Themelore dhe të pezullojë procedurën e përmbarimit.
15. Më 27 shkurt 2015, Gjykata e Apelit (Vendimi Ac. nr. 4312/2014) refuzoi prapësimin e parashtruesit dhe të garantuesve të tij si të pabazuar dhe e vërtetoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Apelit vendosi se:

“Gjykata i refuzoi në tërësi si të pabazuara prapësimet e debitorëve [Parashtruesit dhe garantuesve të tij] me arsyetimin se të njëjtit janë të pabazë dhe më shumë të paraqitur me qëllim të prolongimit të procedurës përmbarimore, ngase arsyet e theksuara në prapësim nuk përkojnë me asnjë nga shkaqet që e pengojnë përmbarimin e lejuar nga gjykatat të përcaktuara në dispozitën e nenit 71 LPP [Ligji për Procedurën Përmbarimore] [...].

Pretendimet ankimore të debitorit Xhevat Berbati, kjo Gjykatë i vlerëson si të pabazuara pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë aplikim të gabuar të së drejtës materiale për të cilën kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se Gjykata e Apelit e ka shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën për mjete efektive juridike dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.
17. Në mbështetje të shkeljes së pretenduar nga neni 31, paragrafi 1 i Kushtetutës, parashtruesi pretendon se *“përkundër insistimit të vazhdueshëm lidhur me*

nxirjen e historisë së llogarisë nga kreditori-Banka asnjëherë nuk ka marrë informata lidhur me transaksionet bankare [...]”.

18. Në përgjithësi, parashtruesi gjithashtu thekson se marrëveshja e kredisë nuk ka mundur të përmbushet si pasojë e vështirësive të tij financiare, të cilat përfundimisht detyruan palët kontraktuese të bëjnë një marrëveshje tjetër. Megjithatë, sipas parashtruesit të kërkesës *“të gjitha propozimet e kreditorit [Bankës] ishin të papërballueshme për debitorin [parashtruesin]”.*
19. Parashtruesi, më tej, pretendon se Banka *“ka inkasuar 150% kamata - interes më tepër se sa kësti mujor, kjo mund të vërtetohet nga historia e llogarisë e 6 qershorit 2015”.*

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka plotësuar kërkesat e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
22. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton se:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij/saj të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar, dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) (d) të Rregullores së punës i cili parasheh:

“(2 Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.
24. Siç është përmendur më lart, parashtruesi pretendon se Vendimi (Ac. nr. 4312/2014, i 27 shkurtit 2015) i Gjykatës së Apelit është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 32 [E drejta për Mjete Juridike]; dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të garantuara me Kushtetutë.

25. Në lidhje me “*mjetet juridike*” dhe “*mbrojtjen gjyqësore të të drejtave*” parashtruesi thjesht u është referuar neneve përkatëse të Kushtetutës pa ofruar ndonjë arsyetim të mëtejshëm se si dhe pse këto të drejta janë shkelur nga Gjykata e Apelit.
26. Lidhur me të drejtën për “*gjykim të drejtë dhe të paanshëm*”, parashtruesi nuk pretendoi ndonjë shkelje që mund të jetë kryer nga Gjykata e Apelit apo nga Gjykata Themelore në Pejë. Në vend të kësaj, parashtruesi i është referuar disa shkeljeve të pretenduara të kryera nga Banka, siç janë norma shumë e lartë e interesit dhe se nuk i është dhënë historia e llogarisë së tij pas kërkesës që kishte bërë. Ai nuk arriti të japë ndonjë arsyetim se si dhe pse e drejta e tij për gjykim të drejtë është shkelur nga gjykatat e rregullta.
27. Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Pejë dhe Gjykata e Apelit kanë arsyetuar vendimet e tyre duke iu referuar dispozitave të ligjit në fuqi, duke hedhur poshtë prapësimin e parashtruesit kundër procedurës së përmbarimit. Lidhur me këtë, Gjykata konstaton se ajo që parashtruesi ngre është çështje e ligjshmërisë dhe jo e kushtetutshmërisë.
28. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës së Apelit në përgjigje të pretendimit të parashtruesit për shkelje të ligjit nga Gjykata Themelore në Pejë, kur refuzoi prapësimin e tij ndaj procedurës së përmbarimit. Gjykata e Apelit vendosi se: “*[...] përfundimi i gjykatës së shkallës së parë [...] është i bazuar dhe ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe dispozitat ligjore andaj edhe Aktvendimi i atakuar ka arsye të plota dhe bindëse*”. *[...] gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë aplikim të gabuar të së drejtës materiale [...]*”.
29. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmëria) që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ajo mund të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
30. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës* Nr. 30544/96, ECHR, Aktgjykim i 21 janarit 1999; shih gjithashtu Rastin KI70/11, i parashtruesit *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011). Fakti se parashtruesi nuk pajtohet me rezultatin e procedurës në rastin e tij nuk ngre një pretendim të argumentuar për shkelje të të drejtave të tij të mbrojtura me Kushtetutë.
31. Gjykata vëren se parashtruesi ka pasur mundësi ta prezantojë rastin para gjykatave të rregullta. Çështja e drejtësisë së procedurës përmbarimore është trajtuar gjerësisht nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit. Kjo e fundit i është përgjigjur të gjitha pretendimeve të parashtruesit lidhur me atë nëse procedura e përmbarimit mund të prolongohet ose jo. Gjykata e Apelit theksoi se parashtruesi nuk e ka mbështetur prapësimin e tij lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi vetëm kishte përmendur atë, por

nuk ka ofruar argumente në atë drejtim. Ai kryesisht ishte interesuar në zgjatjen e procedurës së përmbarimit, gjë për të cilën Gjykata e Apelit nuk ka gjetur asnjë arsye për ta miratuar.

32. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të theksohet se Gjykata Kushtetuese mund vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesit kishin një gjykim të drejtë (Shih rastin, *inter alia*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).
33. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se arsyetimi lidhur me prapësimin e parashtruesit përkitazi me procedurën e përmbarimit, në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu ka gjetur se procedurat pranë Gjykatës Themelore në Pejë nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare. (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, GJEDNJ, vendimi i 30 qershorit 2009).
34. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se parashtruesi ka dështuar të mbështesë pretendimet e tij lidhur me atë se si dhe pse janë shkelur të drejtat e tij nga Gjykata e Apelit.
35. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) (d) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 16 mars 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi